



EKSTRAKT I JETËSHKRIMEVE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË, TË KABINETIT, TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DHE TË MESËM DREJTUES, NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

KABINETI I AVOKATIT TË POPULLIT

Kabineti i Avokatit të Popullit drejtohet nga Drejtori i Kabinetit, dhe ka në përbërje pesë këshilltarë.

Z. ENIO HAXHIMIHALI

Drejtor i Kabinetit të Avokatit të Popullit

Z.Enio Haxhimihali është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2014. Ai ka lindur në Tiranë në vitin 1972. Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1995, ka punuar kryesisht në institucionet kryesore të Drejtësisë dhe jo vetëm. Ai e ka nisur karrierën si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, më pas ka vazhduar në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, pranë Ministrisë së Drejtësisë; me krijimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda ai ka qenë kancelari i parë i kësaj gjykate; ka dhënë kontributin në Drejtorinë e Studimeve dhe Kërkimeve Ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme; pas fitimit të konkursit për Avokat Shteti ka dhënë kontributin në zyrën qendrore të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, etj. Z. Haxhimihali ka një përvojë të admirueshme edhe në kabinetet e ekzekutivit, apo edhe të institucioneve të pavarura. Fillimisht ai ka qenë këshilltar ligjor i Ministrisë të Kulturës, detyrë të cilën e ka ushtruar edhe me ministrin pasardhës; ai ka qenë për disa vite në detyrën e drejtorit të Kabinetit të Ministrisë të Brendshme; për disa vite në funksionin e drejtorit të Kabinetit në Autoritetin e Mediave Audiovizive (fillimisht ish Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit) dhe që nga viti 2014 si drejtor i Kabinetit në institucionin kushtetues të Avokatit të Popullit, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrtojë edhe aktualisht me Avokatin pasardhës. Vlen për tu përmendur që kontributi i tij në Kabinetet e institucioneve të ekzekutivit, falë punës së tij thellësisht teknik, ka bërë që ai të jetë pjesë e kabineteve të forcave të ndryshme politike, pa qenë pjesë e asnjë partie. Ai paralelisht me detyrat e mësipërme, për disa vite akademike, ka dhënë kontributin e tij edhe si Pedagog i jashtëm në: Shkollën Shqiptare të Magjistraturës; Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit shtetëror të Tiranës (ku futi për herë të parë në Universitetet shqiptare një lëndë të re) dhe në Universitetin privat "Albanian University". Vlen për tu theksuar se në institucionet e mësipërme, ai ka qenë jo vetëm lektor, por edhe hartuesi i ciklit të leksioneve përkatëse. Për sa i përket formimit të tij, ai ka kryer studimet e mesme në gjimnazin e përgjithshëm "Sami Frashëri" në Tiranë, studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe pas fitimit të një burse nga Ambasada Franceze në Tiranë, ka ndjekur studimet e thelluara pasuniversitare në Universitetin e Sorbonës, Paris – Francë. Gjithashtu, ai ka ndjekur edhe mjaft trajnime, brenda e jashtë vendit, ku veçohen: Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike (organizuar nga Këshilli i Evropës); kursi i trajnimit: "Drejtësia dhe Policia për vendimmarrësit e niveleve të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor", organizuar në: Angli, Francë, Gjermani dhe Hungari, nga: Komisioni Europian, Kolegji Policor Europian (CEPOL) dhe Shoqata Evropiane e Kolegjeve të Policisë (AEPC); kursi i trajnimit: "Për personat që mbulojnë marrëdhëniet me publikun", organizuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Instituti Shqiptar i Mediave; kursi i trajnimit: "Procesi i kodifikimit të legjislacionit francez", Paris – Francë, organizuar nga Ambasada Franceze në Tiranë dhe zhvilluar pranë institucioneve franceze: Komisioni i Lartë i Kodifikimit, Senat, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe drejtoria e botimit të Gazetës Zyrtare; kursi i trajnimit: "Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut", Paris – Francë, organizuar nga Shkolla Franceze e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, etj. Gjatë karrierës së tij ai ka qenë përfaqësues në

institucione të rëndësishme, brenda e jashtë vendit ku veçohen: Ekspert dhe përfaqësues i shtetit Shqiptar pranë Këshillit të Evropës në Komisionin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (CDPC: European Committee on Crime Problems; PC-R-EV: Select Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money-Laundering Measures (MONEYVAL), Strasburg – Francë; Përfaqësues i Shtetit Shqiptar ne Gjykatën Ad Hoc "Për gjykimin e dëmeve te shkaktuara nga trupat e KFOR ne Shqipëri"; Anëtar i Komisionit të Lartë të Apelimit të Tatim Taksave, organ i pavarur pranë Ministrisë Shqiptare të Financave (si përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë), anëtar i Bordit të Etikës në Këshillin Shqiptar të Medias, etj. Njëkohësisht z. Haxhimihali ka marrë pjesë në dhjetëra studime, ka mbajtur kumtesa e referate brenda e jashtë vendit, si dhe ka qenë pjesëmarrës në shumë projekte të ndryshme ligjore, ku do të veçonim: ekspertizën ligjore si ekspert i pavarur në projektin "Përafrimi i legjislacionit mjedisor shqiptar me atë të B. E.-së", financuar nga Komisioni Europian (Europe Aid/118904/C/SV/AL); Projektin: "Forcimi i rolit te gjyqesorit ne mbrojtje te lirise se shprehjes", financuar nga Komisioni Europian (Europe Aid/133945/L/ACT/AL); Ekspert ligjor dhe hartues i raportit për vlerësimin e zbatimit të Direktivave të Këshillit të Evropës dhe Rekomandimeve të Kuvendit Europian në lidhje me zbatimin e kritereve nga Inspektorët në Shtetet Anëtare, projekt i financuar nga Bashkimi Europian (kontraktuar nga Regional Environmental Center), apo i kontraktuar drejtpërdrejt si ekspert ligjor i pavarur në disa projekte të Bankës Botërore, UNDP, ORT-ja amerikane, programi "Rrjeti i demokracisë në Shqipëri"; apo edhe projekte të financuara nga UNEP (United Nations Environment Program); GEF (Global Environment Facility), KfE (Kreditanstalt für Eissenschaft); Suedish International Development Agency, IDA (International Development Fund); GTZ (Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit - Shoqëria Gjermane për bashkëpunimin teknik); Regional Environmental Center, for Central and Eastern Europe; Milieukontakt Oost-Europa, etj. Gjithashtu z. Haxhimihali ka një karrierë edhe si aktivist i shoqërisë civile, që nis në vitin 1993, si bashkëthemelues dhe anëtar i Bordit Drejtues të organizatës së parë joqeveritare studentore për mbrojtjen e mjedisit "Perla"; më pas ka qenë themelues dhe drejtues i organizatës jofitimprurëse "Juristët Shqiptarë për Mbrojtjen e Mjedisit", anëtar i Shoqatës joqeveritare franceze të juristëve të së Drejtës Mjedisore (AJDE), apo edhe anëtar i Bordit Drejtues të shoqatës joqeveritare "Dajti Alpino-Turistike". Ndër aktivitetet e shumta që ka kryer, veçohet kontributi disaveçar, si trajner për trajnimin e organizatave jofitimprurëse shqiptare, në fushën e pjesëmarrjes publike.

ZNJ. JORIDA RUSTEMI

Këshilltare e Avokatit të Popullit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun, dhe Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Znj. Jorida Rustemi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2014. Aktualisht është pjesë e kabinetit të Avokatit të Popullit prej vitit 2018. Ajo ka një gamë të gjerë interesash, eksperience dhe ekspertize, me një fokus të veçantë në të drejtat e njeriut. Gjatë punës si pedagoge dhe studiuese me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Sociale-UT, lektore me kohë të pjesshme dhe studiuese në Universitetin Shtetëror të Emporias ndërsa përfutuese e një burse të plotë të programit Fulbright, dhe pedagoge dhe studiuese me kohë të plotë si dhe Drejtuese e Qendrës për Këshillim Psiko-social pranë Universitetit Marin Barleti në Tiranë, ajo ka udhëhequr dhe administruar projekte dhe programe të suksesshme në fushën sociale dhe psikologjike me partnerë të tillë si USAID, UNICEF, Save the Children, Plan International, USIS, CAAHT, BE, Fondacioni Soros, Fondacioni gjerman Frederich Ebert, OSBE, Kryqi i Kuq Amerikan etj. Me eksperiencë të gjerë pune ndër të tjera si eksperte e pavarur për Komunikimin me Publikun pranë Koalicionit Shqiptar Kundër Korrupsionit, mbështetur financiarisht nga USAID, Eörd Learning dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), eksperte psikologe në monitorimin e cilësisë së shërbimit psiko-social në ndaj personave me probleme të shëndetit mendor në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri, zbatuar nga Instituti Europian i Tiranës, eksperte kombëtare përgjegjëse për trajnimin e punonjësve të Shërbimit të Provës në "Vlerësim psikologjik të personave në konflikt me ligjin", etj., znj. Rustemi është bashkautore në broshura, raporte, manuale dhe libra si "Prostitucioni-Një plagë e hapur e shoqërisë Shqiptare"; "Drogat"; "Liderët e rinj shkollorë"; "Aftësi të punës me viktimat e trafikut njerëzor"; "Këshillim për aftësitë për jetën"; "Nxitje e etikës dhe përmirësim i aftësive demokratike në institucionet e pushtetit vendor në Tiranë"; "Një manual për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në universitete"; "Përmirësimi i Strategjisë së edukimit për parandalimin e delinkuencës", "Teknika praktike dhe strategji për t'u përdorur në punën me të paraburgosurit dhe të dënuarit me probleme të shëndetit mendor në sistemin penitenciar shqiptar"; Raporte vjetore të Institutit Europian të Tiranës: Mbrojtja e të drejtave të

njeriut në Shqipëri- Raport monitorimi 2011, 2012, 2013, 2014 për kujdesin ndaj shëndetit mendor në sistemin e burgjeve në Shqipëri; Raporte vjetore 2014, 2015, 2016, 2017 të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, etj."

ZNJ. LINDITA DEDËGJONI

Këshilltare e Avokatit të Popullit për çështjet shëndetësore

Znj. Lindita Dedëgjoni është pjesë e kabinetit të Avokatit të Popullit prej vitit 2017. Ajo ka përfunduar studimet e larta universitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, në vitin 1998. Në periudhën Shkurt 2003- Dhjetor 2004 ka ushtruar detyrën si Mjeko e Përgjithshme, Drejtorja Rajonale e Shëndetit Publik Vlore. Në periudhën Shtator 2005 – Korrik 2017 ka mbajtur pozicione të mesme drejtuese në Administratën Publike, si Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Ministria e Transportit, Ministria e Jashtme, Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë. Prej muajit tetor të vitit 2017 ajo ushtron detyrën si Këshilltare pranë Avokatit të Popullit për çështje të investigimeve periodike në Institucionet shëndetësore se si ato operojnë në protokollin e mjekimeve dhe procedurat për të kryer një paketë shëndetësore, si dhe kontrolleve e protokolleve të mjekimeve në Institucionet e sigurisë së lartë, Burgjet etj.

Z. SOKOL SHAMETI

Këshilltar i Avokatit të Popullit për marrëdhëniet me median

Z. Sokol Shameti është pjesë e kabinetit të Avokatit të Popullit prej vitit 2017.

Z. ARDIAN NEZHA

Këshilltar i Avokatit të Popullit për çështjet e Gjykatave dhe Prokurorisë

Z. Ardian Nezha është pjesë e kabinetit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës (Fakulteti i Drejtësisë), me shkeputje nga puna, në vitin akademik 1990-1994, si dhe Kursin pasuniversitar "Marredhenie Nderkombetare dhe Diplomaci" në Akademinë Diplomatike Shqiptare Qendra Rajonale Politike dhe Diplomatike në Oher të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2009. Në periudhën 2009-2011 ka përfunduar me Masterin Shkencor Juridiko-Penal pranë Universitetit të Drejtësisë "JUSTINIANI 1 ". Në vitin 2008 ka marrë Titullin Avokat. Prej vitit 1995 deri në vitin 2019 ka ushtruar detyrën e Prokurorit dhe Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Rretheve Dibër, Pukë, Mirditë, Elbasan dhe Tiranë. Nga viti 2004 deri në vitin 2015 ka qënë Prokuror pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.

ZNJ. BRUNILDA KASMI

Këshilltare ligjore e Avokatit të Popullit

Znj. Brunilda Kasmi është bërë pjesë e kabinetit të Avokatit të Popullit në vitin 2021. Ajo ka përfunduar studimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës (Fakulteti i Drejtësisë), në vitin 1995. Në vitin 2009, ka kryer master (studime pasuniversitare) me drejtim civil pranë Universitetit të Tiranës Fakulteti i Drejtësisë. Në periudhën 1996 -2000, ka punuar si nd/gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në periudhën 2000 -2018, ka punuar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga viti 2011, ka ndjekur programin e studimeve të doktoraturës, pranë Departamentit të të drejtës Civile të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës i papërfunduar. Nga viti 2001 deri në vitin 2018, ka marrë pjesë në programin trajnues të organizuar nga Shkolla Magjistraturës, trajnime në fushën e të drejtës civile, të drejtës administrative, të drejtës familjare, të procedurës civile, të drejtës së punës, në drejtësinë për të miturit etj.

SEKSIONI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje tre ndihmëskomisionerë të cilët janë nëpunës civilë.

Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. NEJLA PEKA

Komisionere e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Nejla Peka prej Marsit 2018, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve sipas Vendimit nr. 41/2018, datë 15.03.2018, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Më herët znj. Peka ka ushtruar detyrën e juristit në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve Rregullatore në Këshillin e Ministrave, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri. Studimet e larta i ka kryer në fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitet 1993 – 1997, si dhe ka kryer studimet pasuniversitare në nivelin "Master në studime evropiane", në Qendrën Ndërkombëtare të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor i shkencave juridike" në të Drejtën Publike, fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si dhe ka fituar titullin shkencor "Profesor i Asociuar" në fushën e së drejtës. Znj. Peka ka kryer një sërë trajnimesh e kualifikimesh, brenda dhe jashtë vendit, në fushën e së Drejtës Publike dhe në çështjet e draftimit të legjislacionit. Në vitin 2007, ajo ka qenë e ftuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare në "Georgia Southern University", Georgia, USA, për të mbajtur leksione të hapura rreth qeverisjes, sistemit politik dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, në këtë universitet. Që prej vitit 1997 e deri në mars 2018, znj. Peka ka qenë nëpunës civil në kategorinë e mesme drejtuese në Kryeministri, si dhe ka qenë e aktivizuar si pedagoge e jashtme në Departamentin e së Drejtës Publike në fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në lëndët "E drejta financiare dhe shkenca mbi financa", "Histori institucionesh" dhe, në nivelin master shkencor, në lëndën "Shteti i së drejtës dhe qeverisja", si Gjithashtu, ajo është pedagoge e jashtme në masterin profesional "Administrimi i institucioneve në sistemin e drejtësisë", në lëndën "Të drejtat e njeriut në procesin penal", në fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, në masterin shkencor "Ekonomia dhe e drejta", në lëndën "Integrimi evropian", të fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, si dhe pedagoge e jashtme në Kolegjin Universitar "Luarasi" prej vitit 2017. Znj. Peka ka qenë trajnere pranë ish Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), për trajnimin e nëpunësve civilë në periudhë prove, si dhe atyre që i nënshtrohen trajnimeve të vazhdueshme. Znj. Peka ka botuar një sërë artikujsh shkencorë brenda e jashtë vendit, si dhe ka realizuar shumë prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore. Ajo është autore e librit "Përmbledhje e legjislacionit tatimor e doganor në Republikën e Shqipërisë". Znj. Peka ka kryer një sërë studimesh në fushat e saj të ekspertizës: në të drejtën administrative, kushtetuese dhe të drejtat e njeriut.

ZNJ. ANILA NEPRAVISHTA

Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Anila Nepravishta është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2000. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve., me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Pas kryerjes së studimeve universitare në vitet 1990-1994 dhe diplomimit në vitin 1994 "Juriste" në Universitetin e Tiranës , në periudhën e viteve 2003-2005 është diplomuar "Master" në Shkollën Pasuniversitare për Studime Evropiane, Tiranë. Po ashtu, në vitet 2010-2013 ka fituar titullin "Doktor", në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ka punuar pas diplomimit, si as.pedagoge në Fakultetin Juridik, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, lektore në periudhën e viteve

1994-1997 në lëndën " E drejta administrative", dhe ka qenë Shefe e Departamentit të së Drejtës Publike. Ndërsa në periudhën e viteve 1997-2000 ka punuar Juriste, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Tiranë. Me krijimin e institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2000, ka filluar punë në këtë institucion dhe vijon të punojë pranë këtij institucioni kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në periudhën e viteve 2000-2010 ka punuar ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm; Për periudhën 2010-2013 është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë për Komisionere për Seksionin e Përgjithshëm. Aktualisht ajo vijon punën pranë këtij institucioni si ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve. Znj. Nepravishta është specializuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike është si trajnere në fushën e Antikorrupsionit.

ZNJ. MATILDA TYLI

Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Znj. Matilda Tyli është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2016. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në vitin 1999, duke u diplomuar për Punë Sociale. Gjatë periudhës së studimeve dhe me pas, ka qenë e angazhuar në shoqërinë civile duke luajtur një rol aktiv në fuqizimin e organizatave jo-qeveritare rinore në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të grupeve të marxhinalizuara si përdoruesit e drogës, fëmijët në nevojë, viktimat e trafikimit. Në prill të vitit 1999, filloi punë në Organizatën Ndërkombëtare "Christian Children Found" (ÇF) ku u trajnuar për eliminimin e Stresit Post Traumatik dhe Traumat e Luftës nga ekspertë dhe profesor të Universitetit të Texasit-USA me qëllim lehtësimin e pasojave traumatike të fëmijëve si rezultat i luftës së Kosovës. Në periudhën 2010-2012, ka përfunduar Masterin e Nivelit të Dytë në Institutin e Studimeve Evropiane të Universitetit të Tiranës dhe tema e mbrojtur në fund të këtij cikli studimesh është "Kujdesi social për fëmijët në nevojë". Në periudhën 2000-2016, ajo punoi pranë institucioneve të administratës publike në nivel zbatues dhe hartues politikash, konkretisht në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në të cilën kontributi i saj ka konsistuar në hartimin e shumë akteve ligjore dhe nënligjore në drejtim të mbrojtjes sociale me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për të garantuar mirëqenie dhe përfshirje shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Paralelisht me detyrat e mësipërme znj.Tyli ka dhënë ndihmesën e saj edhe në hartimin e legjislacionit shqiptar, ku disa nga kontributet më të spikaturat kanë qenë: anëtare e Grupit të Punës për hartimin e ligjit nr. 163/2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Social në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 40/2016 "Për Urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë". Gjatë eksperiencës së punës në administratën publike, përgjegjesitë e niveleve të ndryshme që ka patur, i kanë dhënë znj.Tyli mundësinë që të zhvilloj aftësitë profesionale, paralelisht me kërkesat e reja të zhvillimeve shoqërore për përballimin e sfidave të reja në drejtim të zhvillimit të demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në vitin 2016, znj. Matilda Tyli është emëruar ndihmëskomisioner pranë Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve të institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë.

Z. DONALD FETAH

Ndihmëskomisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve

Z. Donald Fetah është pjesë e insitucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Fëmijëve. Ai ka ndjekur studimet universitare bachelor pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Shkenca Politike përgjatë viteve 2006-2009. Në vitin 2011 përfundoi studimet master shkencor në Teori Politike, me rezultate të shkëlqyera. Në periudhën 2013-2019 ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimit Social, në Njësinë Administrative nr.3, Bashkia Tiranë, duke kontribuar thelbësisht në përmirësimin e cilësisë së jetesës së grupeve në nevojë. Përgjatë viteve 2015-2016, ka ndjekur studimet master në Analizë të Politikave Sociale, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Punë Sociale. Në vitin 2019 është emëruar Ndihmëskomisioner në Seksionin e Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, në institucionin e Avokatit të Popullit.

SEKSIONI PËR ORGANET E ADMINISTRATËS QENDRORE, TË PUSHTETIT VENDOR DHE TË TË TRETËVE QË VEPROJNË PËR LLOGARI TË TYRE

Seksioni i Administratës drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje gjashtë ndihmëskomisionerë të cilët janë nëpunës civilë.

Komisioneri i Seksionit të Administratës është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ.ERJONA BANA (CANAJ)

Komisionere e Seksionit të Administratës

*Znj. Erjona Bana (Canaj) prej Marsit 2019, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, sipas Vendimit nr. 38/2019, datë 26.2.2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Prof. Asoc. Dr. Erjona Bana (Canaj) është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin "Sapienza" Romë, Itali. Ajo mban gradën shkencore PhD në të drejtën Ndërkombëtare dhe atë Bashkimit European nga i njëjti Universitet. Ajo ka punuar në disa nga zyrat më të njohura të avokatëve në Romë (Itali). Ka punuar si këshilltare studentore dhe asistente në Universitetin "La Sapienza" në Departamentin e së Drejtës Ndërkombëtare dhe të Bashkimit European (2007-2009). Znj. Bana (Canaj) ka më shumë se 13 vjet përvojë të gjerë profesionale si pedagoge e së Drejtës së Bashkimit European dhe të Drejtave të Njeriut. Ajo ka mbajtur pozicionin e Dekanes së Komanduar të Fakultetit Juridik në Universitetin Evropian të Tiranës (2017) Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Publike (2016–2017), Përgjegjëses së Departamentit të së Drejtës Private (2015) Përgjegjëses së Departamentit të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane (2011) të Fakultetit Juridik në Universitetin European të Tiranës, etj. Ajo ka një formim akademik dhe kërkimor-shkencor mbi të Drejtën e Bashkimit European në veçanti mbi institucionet e BE-së, *acquis communitaire*, zbatimin e legjisllacionit të BE-së dhe praktikën gjyqësore, tregun e perbashket europian si dhe fusha të shumta të procesit të integritit të Shqipërisë në BE. Ajo gjithashtu ka një formim akademik dhe kërkimor shkencor mbi të Drejtat e Njeriut dhe çështjet e Migracionit. Përveç përvojës akademike, Znj. Bana (Canaj) gjithashtu ka një përvojë të gjatë këshillimi ligjor në fushën e çështjeve evropiane, procesin e integritit dhe të drejtat e njeriut dhe punë si koordinatore dhe / ose eksperte e jashtme në disa projekte ndërkombëtare dhe kombëtare. Ajo ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e projekteve në fushën e së drejtës së Bashkimit Evropian, të drejtës familjare dhe të refugjatëve në nivel kombëtar dhe rajonal, përfshirë këtu punën si trainere në fushat e saj të ekspertizës në Shqipëri dhe Kosovë. Prof. Asoc. Dr. Erjona Bana (Canaj) është gjithashtu trainere në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Ajo është autore-bashkëautore e disa librave akademike në fushat e së drejtës ndërkombëtare, dhe të drejtës evropiane, si E drejta e Bashkimit European. Tiranë, 2020, Migration Laë in Albania, Kluëer Laë International, 2019, E drejta e bashkimit familjar. Ne Bashkimin European dhe ne Shqipëri, UETPRESS, Tiranë, 2018, E drejta e Bashkimit European. Tiranë, 2014, Levizja e lire e personave ne Bashkimin European, Tiranë, 2014, Il diritto al ricongiungimento familiare nel diritto internazionale e dell'Unione Europea, Edizioni Nuova Cultura, Roma, Italia, 2014, E drejta e Bashkimit European, Tiranë, 2011 , E drejta dhe legjisllacioni, Botem, Tiranë, 2013, etj.*

Z. ARBEN GJOLEKA

Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës

Z.Arben Gjoleka është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Gjeologji Miniera të Tiranës, në Degën Gjeologji- naftë në vitin 1991, duke u diplomuar me titullin inxhinier gjeolog-naftë. Pas diplomimit, filloi punë në Ndërmarrjen e Nxjerrjes së Naftës Sheqishtë, Fier. Periudha e punës pranë kësaj Ndërmarrjeje 1991-1993. Në vitin 1994 ka përfunduar studimet në

Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Në vitin 2003 ka fituar titullin "Avokat". Në vitin 2010, është diplomuar "Master i nivelit të dytë" në Universitetin "Marin Barleti". Pas diplomimit, në periudhën 1994-2003, ka ushtruar detyrën e përbaruesit gjyqësor, Kryetarit të Zyrës së Përbarimit, Fier, përbaruesit gjyqësor pranë Zyrës së Përbarimit Tiranë, inspektorit dhe Shefit të Organizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor Shtetëror, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në periudhën 2003-2008, ka ushtruar detyrën e inspektorit, Drejtorit Judidik pranë Sh.a. Aeroport "Nënë Tereza", Tiranë, dhe juristit pranë kësaj Shoqërie në likuidim e sipër. Në vitin 2011 ka fituar titullin "Përbarues gjyqësor privat". Prej vitit 2008 ushtron detyrën e ndihmëskomisionerit pranë "Seksionit për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre". Në detyrën e ndihmëskomisionerit ka dhënë ndihmesën në evidentimin e papajtueshmërisë së projekt-ligjve, ligjeve, akteve nënligjore, me Kushtetutën apo ligje të tjera të veçanta, duke përgatitur me këtë rast kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e përfaqësuar Institucionin e Avokatit të Popullit në këtë Gjykatë, si dhe, përgatitur rekomandime të natyrës legislative apo rekomandime për rivendosjen në vend të një të drejte, lirie apo interesi të ligjshëm të individit prej organeve të administratës publike.

ZNJ. SUZANA CENA

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Suzana Cena është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2018. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, në vitin 2006, duke u diplomuar me rezultate shumë të mira. Pas diplomimit, filloi punë në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, si specialiste, detyrë të cilën e mbajti deri në vitin 2010. Nga viti 2010-2015, punoi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, ku gjatë kësaj periudhe ka mbajtur detyrën e inspektore pranë Sektorit të Përfaqësimit Ligjor dhe më pas atë të shëfes pranë këtij sektori. Në periudhën Dhjetor 2015 deri në Mars 2018, punoi si Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve ligjore, pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. Nga Marsi 2018 e në vijim punon pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ku mban detyrën e Nd/Komisioneres pranë Seksionit të Administratës.

ZNJ. KEJSI RIZO

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Kejsi Rizo është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2018. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës. Ajo ka ndjekur studimet universitare Bachelor pranë Universitetit European të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega Juridik i Përgjithshëm përgjatë viteve 2010-2013. Në vitin 2015 ka përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare, në fushën Master Shkencor në "E drejtë publike, profili e drejtë ndërkombëtare dhe Evropiane". Ka një eksperiencë mbi 7 vjeçare në administratën publike. Pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve universitare, prej vitit 2014 ka punuar pranë institucionit Departamenti i Administratës Publike, në pozicione të ndryshme, si specialiste për rekrutimin e nëpunësve civilë, përgjegjëse e sektorit të procedurave të rekrutimit, dhe nga viti 2016 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave të Rekrutimit në Shërbimin Civil. Gjatë kësaj eksperiencë znj. Rizo është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të menaxhimit të burimeve njerëzore, mirëadministrimit dhe reformës në administratën publike, si dhe ka qënë trajnere e kontraktuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit "Forcimi i strukturave të qeverisjes vendore dhe bashkëpunimit të përfaqësuesve vendorë të zgjedhur në Shqipëri". Prej vitit 2018 znj. Rizo është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit znj. Rizo është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo është përfaqësuese e institucionit të Avokatit të Popullit në emër të Rrejtit Evropian për Institucionet Kombëtare të Drejtave të Njeriut, pranë Komitetit të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale. Znj. Rizo ushtron aktivitetin akademik në lëndët "E drejta ndërkombëtare publike" dhe "E drejta e organizatave ndërkombëtare" pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, prej vitit 2018 e në vazhdim. Ka marrë

pjesë në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për çështje të lidhura me të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë. Gjithashtu, prej vitit 2016 është lektore pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, në modulën "Prezantimi me administratën publike", tema "Shërbimi Civil".

ZNJ. ELISA MJEKRA

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Elisa Mjekra është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës. Ajo ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Ekonomik Aristotel dhe Fakultetin Ushtarak SSAS në Selanik, Greqi në fillim të vitit 2009. Pas diplomimit, ka punuar në një Universitet Privat si specialiste finance. Më pas është emëruar përgjegjëse e financës dhe çështjeve ekonomike në një kompani Greko-Franceze. Në vitin 2011, pas përfundimit të studimeve një vjeçare si "Audituese e Brendshme" është emëruar inspektore Auditi pranë Ministrisë së Brendshme, ku ka punuar deri në vitin 2019.

ZNJ. DONIKA DACI

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës

Znj. Donika Daci është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2020. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Administratës. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2002. Nga vitet 2005-2014 ka punuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirane në pozicionet specilaiste, përgjegjëse sektori dhe specialiste në Sektorin e Apelit pranë ZQRPP Tiranë. Ne vitet 2014-2016 ka punuar pranë Bashkisë Tiranë (DPPTV dhe Tirana Parking) në pozicionin juriste, specialiste prokurimesh. Në vijim në vitet 2017-2020 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. Eksperiencat e fituara gjatë punës në sektorë të administratës publike kanë shërbyer në pjesmarrjen e saj në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në përmirësimin e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si dhe aktivizimi pranë ASPA mbi trajnimin e specialistëve në përgatitjen e akteve në fushën e prokurimeve publike.

Z. SHKËLQIM KËRLUKU

Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës

Z. Shkëlqim Kërluku është bërë pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2021. Aktualisht, mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Administratës. Ai është diplomuar për shkencat juridike në Universitetin e Bukureshtit, Rumanë në vitin 2000. Ka një eksperiencë të gjatë në fushën e të drejtës civile dhe administrative si në sektorin privat ashtu edhe atë publik. Fusha e veprimtarisë së tij ndër të tjera përfshin ekspertizë të thelluar në zhvillimin e sektorëve të strategjisë së vecantë kombëtare, përgatitjen e metodologjive për çështje rregullatore dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Është angazhuar si konsulent kombëtar për ngritjen e kapaciteteve njerezore në administratën publike për proceset konkurruese dhe menaxhimin e projekteve të partneritetit publik-privat. Ka ndjekur programe të posacme të Departamentit të Përgjithshëm të Europës në lidhje me njohjen, interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe i klasifikuar si Trajnues Kombëtar për të drejtat e njeriut (Mars 2005). Botues i disa artikujve me fokus trajtimin shtetëror të të drejtave të pronarëve në Shqipëri dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave për këto çështje.

SEKSIONI PËR POLICINË, SHËRBIMIN SEKRET, BURGJET, FORCAT E ARMATOSURA DHE PUSHTETIN GJYQËSOR

Seksioni për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor (Seksioni i Veçantë) drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i Seksionit të Veçantë është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. ERMONELA RUSPI

Komisionere e Seksionit të Veçantë

Znj. Ermonela Ruspi prej Marsit 2019, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit, sipas Vendimit nr. 37/2019, datë 26.2.2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Prof.Asoc.Dr.Ermonela Ruspi ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në vitin 2000. Më tej ka kryer studimet pasuniversitare e në vijim ato doktole pranë Universitetit të Tiranës, në përfundim të të cilave në vitin 2011 ka fituar gradën "Doktor". Gjatë veprimtarisë akademike, në vitin 2010 ka fituar titullin akademik "Docent" e në vitin 2015 titullin akademik "Profesor i Asociuar". Pas përfundimit të studimeve universitare, fillimisht ka punuar në disa institucione të administratës publike vendore dhe qendrore. Për periudhën 2004 - 2019 ka qenë e angazhuar me kohë të plotë në veprimtarinë akademike në universitetin "Eqrem Çabej". Përveç mësimit, njëkohësisht është angazhuar në funksione drejtuese në pozicionin e Përgjegjësit të Departamentit, Dekanit etj. Po ashtu, për disa vite ka qenë pedagoge e jashtme në Departamentin e të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Znj.Ruspi ka dhe një veprimtari të pasur shkencore. Ajo ka botuar një sërë artikujsh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, ka marrë pjesë në projekte shkencore, si dhe ka referuar si autore e parë apo bashkëautore në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e mirë e të cilave janë në fushën e të drejtave të njeriut.

Z. SOTIRAQ NUSHI

Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë

Z. Sotiraq Nushi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2000. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dega "Polici" në vitin 1985, me rezultate të shkëlqyera. Ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 1995, me rezultate të larta. Ka përfunduar studimet "Master i Nivelit të Dytë" në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2011, duke u diplomuar me Medaljen e Artë. Për periudhën 1985-1993 ka punuar si oficer policie në Drejtorinë e Punëve të Brendshme Tiranë në detyra të ndryshme, në policinë kriminale dhe atë të rendit. Për rezultate të larta në punë është shpërblyer disa herë materialisht dhe moralisht. Me Dekretin Nr.7310, dt. 16.06.1989 të Presidentit të Republikës është dekoruar me medaljen "Për ruajtjen e rendit shoqëror". Nga viti 1995-2000 ka punuar në profesionin e avokatit, anëtar i Dhomës së Avokatëve Tiranë. Nga muaji gusht 2000 e në vijim punon në Institucionin e Avokatit të Popullit, në Seksionin e Veçantë, në detyrën e ndihmëskomisionerit. Shtator 2012 deri në gusht 2013 është komanduar në detyrën e Drejtuesit të Njësisë për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit. Për periudhën 2002-2003 ka qenë pedagog i jashtëm në Akademinë e Policisë Tiranë në lëndën e të Drejtës Administrative. Më pas ka dhënë leksione të herpashershme për të drejtat e njeriut me kurset pasuniversitare në Akademinë e Policisë. Gjatë viteve 2011-2014 ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin jo Publik "Akademia e Biznesit" Tiranë në lëndën e Kriminalistikës dhe i të Drejtës së Falimentimit.

Z. ERIND PIRANI

Ndihmëskomisioner në Seksionin e Veçantë

Z. Erind Pirani është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2003. Aktualisht mban pozicionin Ndhmëskomisioner në Seksionin e Veçantë, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Më herët ai ka ushtruar detyrën e ndihmëskomisionerit në Seksionin e Administratës, deri në vitin 2020. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkoder në vitin 2001. Pas diplomimit ka ndjekur studimet pasuniversitare master në Universitetin "Karl Ruprecht" në Heidelberg, Gjermani, dhe me pas studimet doktorale në ISE Tiranë. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Z. ADIL SKUQI

Ndhmëskomisioner në Seksionin e Veçantë

Z. Adil Skuqi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht mban pozicionin Ndhmëskomisioner në Seksionin e Veçantë. Ai ka përfunduar Fakultetin e drejtësisë në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike "Luarasi" në vitin 2008. Karrierën në Institucionin e Avokatit të Popullit e ka nisur në vitin 2008 ku fillimisht ka kryer detyrën e sekretarit të Seksionit të Përgjithshëm. Më pas është emëruar përgjegjës në Sektorin e Informacionit dhe Pritjes së Popullit. Në Qershor të vitit 2008 është emëruar ndihmëskomisioner në Mekanizimin Kombëtar të Parandalimit të Torturës. Pas rreth katër vitesh punë në MKPT është transferuar me detyrë pranë Seksionit të Veçantë, seksion që ndër të tjera shqyron edhe ankesa të të personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar/arrestuar nga Policia e Shtetit. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

ZNJ. FJONA ZAÇAJ

Ndhmëskomisionere në Seksionin e Veçantë

Znj. Fjona Zaçaj është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht mban pozicionin Ndhmëskomisionere në Seksionin e Veçantë. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Krajovës, Rumani, në vitin 2004. Në vitin 2008 përfundoi studimet master në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Në periudhën 2004 - 2007 ka punuar juriste pranë njësisë së qeverisjes vendore, Fondacionit të Biznesit të Vogël, si dhe eksperte e jashtme e Qendrës për Nisma Ligjore Falas. Gjatë viteve 2007-2009 ka ushtruar detyrën e specialistes në Drejtorinë Juridike të Ministrisë së Brendshme dhe më pas, 2009-2016 ka mbajtur postin e përgjegjëses së sektorit të akteve në këtë drejtori, ku ka ndjekur procedurat për hartimin dhe miratimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, dhënien e asistencës dhe mendimit ligjor, përfaqësimin e ministrisë në grupe pune etj. Në periudhën 2016-2017 ka punuar si ndihmëskomisionere në Mekanizimin Kombëtar për Parandalimin e Torturës, pranë Avokatit të Popullit, me fokus inspektimin dhe vëzhgimin rregullisht të ambienteve ku mbahen personat e privuar nga liria. Gjatë vitit 2018 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me objekt studimin e dosjeve dhe përgatitjen e relacioneve në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Ka marrë pjesë në trajnime e seminare të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë vendit.

MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS, TRAJTIMIT OSE DËNIMIT TË EGËR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

Mekanizmi kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës (MKPT) drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i MKPT është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. ERMONELA XHAFA

Komisionere e Mekanizmit kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

Znj. Ermonela Xhafa prej Marsit 2018, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Mekanizmit kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, sipas Vendimit nr. 43/2018, datë 15.03.2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Znj. Xhafa ka ndjekur studimet në shkollën e mesme të përgjithshme " Petro Nini Luarasi", Tiranë me rezultate të shkëlqyera. Ajo është diplomuar juriste, në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti i Tiranës në vitin 1996 me rezultate të larta; në gusht 2002 ka mbaruar "Master në Shkenca MSc "Global Security", Royal Military College of Science Universiteti i Cranfield OXF UK; ajo ndjek studimet doktorale, në fushën e të drejtës tregtare në Universitetin Tor Vergata, Romë Itali.

Eksperiencia profesionale:

Drejtorja e Bashkëqeverisjes- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (dhjetor 2017-31 mars 2018); Drejtore Projekti (prill 2017- nëntor 2017); Ministria e Drejtësisë - Drejtore e Përgjithshme e Jetësimin të Prioriteteve, Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Integritimit dhe Projekteve (tetor 2013 – prill 2016); Ministria e Drejtësisë-Këshilltare e Ministrit (shtator 2013 – tetor 2013); Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës - Përgjegjës Sektori (janar 2006 – shtator 2013); Ministria e Ekonomisë - Drejtore i Zyrës Antidumping, (prill 2003 – janar 2006); Ministria e Mbrojtjes- Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimin (mars 2001 – mars 2003); Kontrolli i Lartë i Shtetit- Inspektore/Juriste (mars 1998 – tetor 2000); Rektorati i Universitetit të Tiranës- Jurist(janar 1998-shkurt 1998).

Gjatë periudhës tetor 1999 – shtator 2006 është angazhuar si pedagoge e jashtme në Departamentin e së Drejtës Civile, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Znj. Xhafa ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e Strategjisë në sektorin e Drejtësisë, Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, Strategjisë për Administratën Publike, Strategjisë kundër Korrupsionit. Gjithashtu, ka qenë zv.kryetare e grupit të punës për Prioritetin e 2-të. Përfaqësuese i Ministrisë së Drejtësisë në disa nga nënKomitetet Shqipëri-BE dhe pjesë e stafit teknik të Dialogut të nivelit të lartë BE –Shqipëri.

Ajo ka qenë Pika Kombëtare e Kontaktit të vendeve anëtarëve të Konferencës së Hagës; Pika Kombëtare e Kontaktit për Shqipërinë në EUROJUST; Koordinatorja Antikorrupsion për Ministrinë e Drejtësisë për iniciativa dhe politikat e masave parandaluese Antikorrupsion; Projektleader i projektit "Përmirësimi i sistemit të përbarimit në Shqipëri" projekti i binjakëzimit BE-AL. Ka qenë pjesë e grupeve të negociatave në disa nga marrëveshjet e investimeve të Shqipërisë me shtetet e tjera.

Znj. Xhafa është trajner për bashkëpunim juridik ndërkufitar në çështjet civile, trajner për të drejtat e njeriut për zyrtarët e administratës publike, të certifikuar nga OSBE-ja dhe ASPA. Ajo ka shërbyer si eksperte dhe konsulente në një sërë projektesh, me fokus të drejtat e njeriut (gratë dhe fëmijët), çështjet e ekonomisë, qeverisja lokale etj.

Ka kryer një sërë trajnimesh dhe specializimesh brenda dhe jashtë vendit për çështjet e të drejtave të njeriut, sistemin e drejtësisë, për çështjet e sigurisë, marrëdhëniet ndërkombëtare, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, tregtinë ndërkombëtare etj.

Znj. Xhafa është autore në një sërë publikimesh, studimesh kërkimore dhe shkrimesh shkencore në revista juridike si dhe lektore në një sërë trajnimesh, konferencash dhe seminaresh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Znj. Xhafa është zotëruese shumë e mirë e gjuhës angleze dhe italiane, si dhe ka njohuri të mira të gjuhës gjermane.

Z. BESNIK DEDA

Ndihmëskomisioner pranë MKPT

Z. Besnik Deda është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2013. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet e larta në 1982-1986 Akademine Ushtarake, Tirane. Me pas ka kryer studimet në degen e drejtësisë në Universitetin Ismail Qemali, Vlore në vitin 2005-2009. Nga viti 1986 deri në vitin 1996 ka kryer detyra të ndryshme në Forcat e Armatosura. Ka fituar titullin avokat në vitin 2010. Ka kryer detyren e Keshilltarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Financave në vitet 2002-2005. Deri në vitin 2013 ka ushtruar profesionin e lirisë të avokatit ku ka trajtuar problematikat e ndryshme civile. Në Janar të vitit 2013 emërohet Drejtor i Sherbimeve ndaj Qytetareve pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Me prej vitit 2015 e deri sot ushtron detyren e ndihmes komisionerit në këtë institucion. Gjatë karrierës së tij në administratë ka kryer shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit me tematika të ndryshme si dhe ka botuar disa artikuj në revista me fokus të drejtat e njeriut.

ZNJ. NERTILA ISMAJLGECI

Ndihmëskomisionere pranë MKPT

Znj. Nertila Ismajlgeci është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2018. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale në vitin 2008 në Degën Psikologji me Titullin Psikolog Klinikist. Për një periudhë 1 vjeçare ka punuar si Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore pranë Kompanie Private. Prej vitit 2009 deri vitin 2013 ka punuar pranë Sherbimit Kombëtar të Punësimin në pozicione të ndryshme si Specialiste dhe Përgjegjëse Sektori. Prej vitit 2014 deri në vitin 2018 ka qënë kryetare e Shoqatës për mbrojtjen e të larguarve nga Administrata, pjesë e shoqërisë civile. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Z. HAZBI SELITA

Ndihmëskomisioner pranë MKPT

Z. Hazbi Selita është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2020. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2011 si Jurist- Specializuar në "e Drejtë Penale". Në periudhën 2012 deri 2016, ka ushtruar detyrën e Specialistit në Drejtorinë e Përgjithshme të Sherbimit të Provës, Zyra Vendore Tiranë. Nga viti 2016 deri në vitin 2019 ka punuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në pozicione të ndryshme si Këshilltar dhe Ndihmës – inspektor. Për periudhën Qershor 2019 deri në Janar 2020 ka punuar si ekspert i jashtëm në Institucionin e Avokatit të Popullit me aktivitetet dhe përgjegjësitë kryesore të inspektimit në institucionet e privimit të lirisë për të Miturit në Konflikt me Ligjin".

ZNJ. GLORIA ÇARKAXHIU

Ndihmëskomisionere pranë MKPT

Znj. Gloria Çarkaxhiu është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2020. Aktualisht mban pozicionin *Ndihmëskomisionere pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ajo ka përfunduar studimet e larta për Juridik në Fakultetin e Shkencave Juridike, Ekonomike dhe Politike të Universitetit Aristoteli të Selanikut në Greqi ekuivalentuar Master Shkencor. Ka një eksperiencë mbi 10 vjeçare në profesionin e juristit. Pas përfundimit të studimeve për një vit ka punuar si asistent-avokate dhe në vitin 2012 ka marrë titullin "Avokat" nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Prej vitit 2012 deri në vitin 2020 ka punuar si eksperte në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas ka qënë Përgjegjëse e Sektorit të Diasporës, pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ka marrë pjesë në shumë trajnime të zhvilluara si brenda dhe jashtë vendit për hartimin e legjislacionit, për procesin legjislativ shqiptar dhe implementimin e legjislacionit me *acquis communautaire*, për parandalimin dhe adresimin e dhunës seksuale dhe të bazuar në gjini në institucionet e mbyllura, për forcimin e Antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes Përmirësimit të Masave të Konfiskimit të Pasurive etj. Ka qënë eksperte në grupet e punës të ngritura nga Ministri i Drejtësisë kryesisht për analizimin dhe hartimin e legjislacionit përgjatë reformës në drejtësi dhe akteve nënligjore në zbatim të saj, paketës penitenciare etj. Ka qënë pjesë e grupit të ekspertëve në Komitetin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit (Moneyval) të Këshillit të Evropës, përfaqësuese në Grupin e Punës për Vlerësimin Universal Periodik (UPR) të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara etj.*

SEKSIONI I PËRGJITHSHËM

Seksioni i Përgjithshëm drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje katër ndihmëskomisionerë.

Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

ZNJ. VILMA SHURDHA

Komisionere e Seksionit të Përgjithshëm

Znj. Vilma Shurdha prej Marsit 2019, ushtron për një mandat 4-vjeçar funksionin e Komisionerit të Seksionit të Përgjithshëm, sipas Vendimit nr. 36/2019, datë 26.02.2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Z. ALKET JAUPI

Ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm

Z. Alket Jaupi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2000. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisioner në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, në vitin 1995. Në vitin 2018, ka fituar gradën shkencore "Doktor", në fushën e sigurisë dhe të drejtave të njeriut, në Akademinë Ushtarake, Tiranë. Pas diplomimit ai ka punuar në profesionin e juristit në disa subjekte private, si dhe në shoqëri tregtare me kapital shtetëror, duke ushtruar njëkohësisht për disa kohë edhe profesionin e avokatit. Paralelisht ai ka qënë pedagog i jashtëm në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës dhe në disa universitete jopublike, si dhe vazhdon të jetë pedagog i jashtëm (lektor), në Kolegjin Universitar të Biznesit. Paralelisht me detyrën, ai ka dhënë kontributin e tij në hartimin e legjislacionit shqiptar, si pjesëmarrës në projekte të USAID dhe Fondacionit "Soros", për të drejtën e informimit, kodin e procedurave administrative, si dhe të drejtat e minoriteteve. Në periudhën 2002-2003, ai ka qënë anëtar i Komitetit Teknik, për Institucionet e Sektorit të Drejtësisë, i ngritur nga bashkëpunimi i vendit tonë me Programin Danez të Ndihmës në Tranzicion. Ai është çertifikuar nga ASPA në vitin 2016, si trainer i administratës publike. Së fundmi, z. Jaupi është çertifikuar si pjesëmarrës i në Programin e Liderimit të Vizitorit Ndërkombëtar "Zhvillimi i të Drejtave të Minoriteteve", zhvilluar në vitin 2018, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

ZNJ. MIMOZA MORINA

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj.Mimoza Morina është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2006. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Politike, Dega Filozofi në vitin 1988 dhe Fakultetin Juridik, Universiteti Tiranë në vitin 2001. Më datë 20.03.2004 ka fituar titullin "Avokat". Për periudhën Prill 1989-Korrik 1996 ka punuar si specialiste për nxjerrjen e të dhënave statistikore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Për periudhën Gusht 1996-Dhjetor 2005 ka punuar pranë Shërbimit Social Shtetëror si Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun; Inspektore e Ndihmës Ekonomike dhe Juriste në Sektorin e Aftësisë së Kufizuar. Gjatë eksperiencës si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit është trajnuar vazhdimisht brenda dhe jashtë vendit për çështje të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

ZNJ.LINDITA XHILLARI

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Lindita Xhillari është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2008. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm, me statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues. Ajo ka

mbaruar studimet ne Fakultetin e Drejtesise, Universiteti i Tiranës ne vitin 1996. Ka mbaruar masterin shkencor ne katedren civile ne Fakultetin e Drejtesise ne vitet 2003-2005. Me tej ne vitet 2013-2019 ka kryer studimet e thelluara doktrale prane Universitetit te Tiranës, Fakultetit te Drejtesise, Katedres Publike dhe ka fituar graden "Doktor i Shkencave". Per 2 vjet ka punuar si koordinator ne Shoqaten e Atlantikut te Veriut, organizate e shoqerise civile. Me pas per periudhen 1998-2002 ka punuar si juriste ne Ministrine e Shendetesise, e me tej si specialiste prokurimi ne strukturat e varesise se kesaj ministrie. Ne vitet 2002 deri ne 2007 ka mbajtur pozicionin e Drejtores se Zyres Juridike prane Presidentit te Republikës se Shqipërisë. Ne vitin 2007-2008 ka punuar si Drejtores Juridike ne Dhomen e Tregtise dhe Industrise, Tirane. Per periudhen 1996-2005 ka qene pedagoge e jashtme ne Fakultetin e Drejtesise, katedra Civile, lenda ""E drejte Biznesi"", ne Fakultetin Ekonomik.

ZNJ.ETLEVA SHESHI

Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm

Znj. Etleva Sheshi është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2019. Aktualisht mban pozicionin Ndihmëskomisionere në Seksionin e Përgjithshëm. Ajo mban titullin Master në Punë Sociale. Me një experiencë pune rreth 25 vjeçare në fushën e të drejtave të njeriut e specifikisht të drejtave të grave, fëmijëve, të rinjve si dhe personave LGBTI. Përfaqësuese e Shqipërisë në grupin e ekspertëve "Ad Hoc Committee on preventing and combating violence against women and domestic violence (CAHVIO) "për hartimin e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave; Anëtare e Komitetit për Barazinë Gjinore të Këshillit të Europës 2009 – 2019. Ka marrë pjesë në proceset e hartimit të disa prej strategjive kombëtare si Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2001-2005, Strategjia Kombëtare e Rinisë 2007-2013, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2011-2015, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2015-2020, Planin Kombëtar të Veprimit kundër diskriminimit të personave LGBTI 2015-2020, proceset e hartimit të legjislacionit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, raporte kombëtare për fëmijët, gratë dhe LGBTI, procesin e ngritjes dhe vënies në funksionim të strehëzës kombëtare për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, hartimin e standarteve të strehëzave, organizimit të disa fushatave sensibilizuese për mbrojtjen e të drejtave të grave, nxitjen e barazisë gjinore, nxitjen e pjesëmarrjes së grave në vendimarrje, për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore, etj. Lektore e jashtme në Fakultetin e Shkencave Sociale për Politikat Gjinore dhe institucionet e barazisë gjinore.

ADMINISTRATA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Administrata e institucionit të Avokatit të Popullit përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili është njëkohësisht edhe nëpunësi më i lartë civil i institucionit, që ka në varësi Sektorin e Integritimit Evropian dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, si dhe Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (ku përfshihet Sektori i Financës dhe Prokurimeve, Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Shërbimeve dhe Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve).

Z.FATBARDH ZENELAJ

Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit

Z. Fatbardh Zenelaj mban detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2014. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 1996. Gjatë studimeve universitare (1995), në kuadër të Programit Tempus të financuar nga Këshilli i Evropës, u përzgjedh për të ndjekur studime ligjore në Universitetin e Lejdenit (Hollandë). Në vitin 2007, ka marrë nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës titullin Master në të Drejten Publike. Gjithashtu, është trajnuar në fushën e ligjit (veçanërisht në të drejtën ndërkombëtare dhe integritimin evropian) përmes kualifikimeve të ndryshme të realizuara brenda dhe jashtë vendit ku vlen të përmenden kualifikimet/trajnimet në SHBA, Hollandë, Spanjë, Greqi, Bullgari etj. Ai ka një eksperiencë mbi 24-vjecare në administratën publike ku ka mbajtur dhe ushtruar detyra të ndryshme, duke filluar nga jurist në Ministrinë e Transporteve, Koordinator pranë Ministrisë së Shtetit për Integritimin Evropian, Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Integritimit Evropian, Drejtor Kabineti/Drejtor i Burimeve Njerëzore, Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikut në Autoritetin e Mediave Audiovizive. Z. Zenelaj ka qenë anëtar në shumë grupe pune në fusha të ndryshme të së drejtës (përfshirë dhe procesin e vetëgjyqësorisë dhe polici), ku ka ofruar ekspertizën dhe njohuritë të tij, si dhe ka kontribuar si ekspert ligjor në shumë projekte të financuara nga organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri në fusha të tilla si integritimi evropian, konkurrenca, media etj. Që nga muaji shtator 2020, është lektor pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

ZNJ. DEJANA BURGIIJA

Drejtor i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve

Znj. Dejana Burgija është pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit prej vitit 2017, fillimisht si anëtare e kabinetit e nga viti 2019 si drejtore e Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve. Ajo ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tiranës, duke marrë titullin "financiere" në vitin 2004. Në vitin 2012 ka përfunduar ciklin e studimeve pasuniversitare profesionale intensive Euro-Mediterranean Studies pranë University EMUNI, Portoroz, Slovenia. Në vitin 2013 ka përfunduar studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tiranës në degën Menaxhim Biznesi (Sipërmarrje). Ka studiuar pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare, Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, në fushën Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Pas përfundimit të studimeve universitare, znj. Burgija ka punuar për periudhën 2004-2009 në sektorin bankar, si financiere e më pas si drejtuese e njëres prej agjencive të Bankës Kombëtare Greke. Prej vitit 2009 deri në vitin 2013 ka drejtuar Drejtorinë Rajonale të Punësimit Durrës. Për periudhën 2013-2017 ka punuar financiere në biznes privat dhe njëkohësisht si lektore pranë Departamentit Financë-Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, për lëndët "Paraja dhe banka" dhe "Sistemet Financiare në BE". Znj. Burgija është trajnuar në fusha të ndryshme si menaxhimi i migracionit me qëllim punësimin në Ballkanin perëndimor, ngritje e kapaciteteve të komiteteve rajonale për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, për politikën dhe legjislacionin lidhur me personat me aftësi të kufizuara, për përfshirjen gjinore dhe forcimin e mekanizmave shtetërore për barazinë gjinore në Shqipëri, për përfaqësimin e sektorit publik dhe planifikimin strategjik, si dhe ka ndjekur trajnimin e parë për ndërmjetësues, të drejtat e njeriut, etj.